



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 02-11/22
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATË/A	28.10.2022
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL:

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së njëmbëdhjetë (11) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 28.10.2022, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti, nënkyretarin e Komunës së Junikut z. Besart Tofaj, drejtori i drejtive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit. Në mbledhje nga drejtoret prezent ishin: znj. Leunora Shehu-AD, znj. Vjollca Qestaj-BF, znj. Gentiana Tofaj-DZHE, z. Zenun Shala-DUKM, z. Xhavit Velijaj, z. Fatos Shala-DSHMS, z. Demokrat Ganijaj-DSHPMS.

Anëtarët prezent

- | | |
|--|-------------------------------------|
| 1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK | 10. Rajmonda Krasniqi - Anëtar, AAK |
| 2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK | 11. Erleta Qestaj - Anëtar, AAK |
| 3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK | 12. Festina Maloku - Anëtar, AAK |
| 4. Albertina Gacaferi - Anëtare, LDK-ka munguar | 13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV |
| 5. Ermelinda Llolluni - Anëtare, LDK | 14. Eliza Pepshi-Anëtare, LVV |
| 6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK | 15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV |
| 7. Leonard Llolluni - Anëtar, AAK | |
| 8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK | |
| 9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK | |

Rendi i ditës i paraparë

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,
2. Raporti periodik i buxhetit për përudhen Janar-Shtator 2022 i Komunës së Junikut,
3. Formimi i komisionit për plotësim-ndryshim të rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba kommunale për vitin 2023,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës për hartimin e rregullores për Institucionet edukativosimore të Komunës së Junikut,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e një anëtari të KKSBS-së,
6. Shqyrtimi i kërkesës së antarit të kuvendorit rrëth mirëmbajtjes dhe kujdesit të deponisë së materialeve inerte në Komunën e Junikut,
7. Kërkesë për Draft Statutin e QKMF-së "Dr.Ali Hoxha"-Junik,
8. Të ndryshme.

z.Shpejtim Gacaferi, e hapi debatin rrëth rendit te ditës.

z.Leonard Llolluni, përshëndetje për të gjithë, ne grupi i AAK kemi patur kërkesë qe si rend të ditës te hynë edhe shqyrtim i varrezave në fshatin Gjocaj, fshat në kuadër te Komunës së Junikut, dhe sipas informatave që kam kjo kërkesë ka kaluar edhe në KPF, është votuar pro dhe nuk ështeë ne rend të ditës, me çfarë te drejte ka ndodhur kjo?

z.Shpejtim Gacaferi, është diskutuar në KPF por nuk është votuar për të, ka qenë kërkesë e z.Xhemë Tofaj, por ishin dy pika për rend të ditës nga ana e tij, dhe ne bazë të rregullores se kuvendorit antareve te kuvendorit i lejohet që të bejë kërkesë vetëm për një pikë të rendit të ditës pika e gjashtë e rendit të ditës ka hyrë për shqyrtim për mbledhjen e sotit pasi qe për ketë pikë është përcaktuar, pastaj kjo kërkesë ka ardhur nga znj.Rajmonda Krasniqi, qe kjo kërkesë të vijë si kërkesë në mbledhjen e kuvendorit, por nuk është se është votuar dhe nuk ka kaluar ne KPF.

znj.Rajmonda Krasniqi, përshendetje për te gjithë, ne në KPF e kemi diskutuar që të hynë si pikë e rendit të ditës edhe kjo kërkesë, arsyja ishte qe ne kuvendorit te janë prezent te gjithë delegatet dhe ti kryesues e ke konfirmuar me ok, dhe kjo kështu ka mbetur, dhe kur ju e keni pohuar me ok e kam marur sit te perfunduar kete queshtje.

z.Shpejtim Gacaferi, ne baze te proceduarve administrative fshatrat Gjocaj dhe Jasiq janë vendbanime të komunes së Junikut, mirëpo sipas ligjit të parkut kombëtarë ajo pjesë menaxhohet nga parku kombëtarë dhe në ketë kuadër inspektorët e Komunës se Junikut nuk kanë të drejtë te inspektojnë ne atë pjesë përpos inspektorët e parkut nacional, përpos kësaj me ketë çështje janë duke u marrë organet e policisë dhe të prokurisë dhe ne nuk kemi çka të bëjmë më tepër.

z.Zenel Maloku, përeshendetje për të gjithë, kryesues mu me mbetet hatri te ti sepse ketë çështje po e bene te lehtë, jo parku jo anej jo këndejej, kjo për mua janë "pollavra", a ka marr leje dikush në park per ti rrafshuar këto vorre? Ketë punë e ka berë Komuna nuk e ka berë babai im, e ka berë drejtori i kryetarit te Komunës se Junikut, dhe kjo çështje është e rëndë për Junikun dhe për familjet e atyre varreve, dhe më e rënda është për ato vorre qe janë shkatërruar.

z.Lulzim Gacaferi, përshëndetje për të gjithë, meqë është drejtoresha e administratës prezent unë kam një pyetje, fshatrat Jasiq dhe Gjocaj a administrohen nga komuna e Junikut dhe qytetarët e ketyre dy fshatrave a paguajn taksa ne Komunën e Junikut, tatimin ne pronë dhe taksat tjera?

znj.Leunora Shehu, përshëndetje për të gjithë, taksa e tatimit ne pronë nuk përfshihet te drejtoria e administratës

z.Shpejtim Gacaferi, z.Lulzim Gacaferi, jemi te pikë e rendit te ditës.

z.Lulzim Gacaferi, unë nuk levizi nga kjo kerkesë, qytetarët e ketyre dy zonave a paguajnë taksa ne Komunën e Junikut? Andaj dua pergjigje nga kryetari i Komunës drejtorët, mos me injoroni Kryesues.

z.Shpejtim Gacaferi, nuk mundeni te merrni pergjigje pa kaluar rendi i ditës.

z.Sadri Krasniqi, përshendetje për te gjithë, unë po i kuptoj z.Zenel Malokun, e z.Leonard Llollunin, edhe po e di edhe qëllimin e tyre, si gjest çdo kush që ka ndëgjar askujt mirë nuk i ka ardhur dhe e kan dënuar dhe nuk di se çka kemi ne te diskujtojmë këtu në kuvend ku rasti është ne polici dhe prokuri, andaj ne si LDK e perkrahim ketë rend te ditës te propozuar.

z.Leonard Llolluni, unë propozoj që si pikë e rendit te ditës te hynë edhe diskutimi për shkatrrimin e varrezave ne fshatin Gjocaj.

z.Shpejtim Gacaferi, ateher fillimisht votojmë për propozimin tim që patëm rendin e ditës me pikën shtesë te kerkeses se drejtorisë se Shëndetësisë, pastaj e quesim në votim edhe kerkesën e grupit te AAK-se, kush është për rendin e ditës te propozuar me pikë shtesë kerkesën e Drejtorisë se Shëndetësisë? për 8 vota, kundër 6, abstenim 0 vota, tanë e ques ne votim edhe kërkuesën e grupit te AAK-se, kush është per? 10 vota për, kunder 4 vota, abstenim 0 vota, konstatoi se u miratua rendi i dites me këto pikë:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,
2. Raporti periodik i buxhetit për periudhen Janar-Shtator 2022 i Komunës së Junikut,
3. Formimi i komisionit për plotësim-ndryshim të rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2023,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkuesës për hartimin e rregullores për Institucionet edukativosimore të Komunës së Junikut,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkuesës për zëvendësimin e një antari të KKSB_së,
6. Shqyrtimi i kërkuesës së anëtarit të kuvendit rrëth mirëmbajtjes dhe kujdesit të deponisë së materialeve inerte në Komunen e Junikut,
7. Kërkuesë per Draft Statutin e QKMF_së “Dr.Ali Hoxha”-Junik,
8. Diskutimi per shkatrrimin e Varrezave ne fshatin Gjocaj.
9. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,

z.Lulzim Gacaferi, kërkoj nga procesmbajtësi që fjalisë time mos ti mungoj as një gerrëm pikë apo prese te prezentojet ashtu qysh unë flas.

z.Shpejtum Gacaferi, vërejtje tjera nuk ka, e qes ne votim procesverbalin e mbledhjes se kaluar kush është për? për 14 vota, kundër 0 vota, abstenim 0 vota, konstatoi se procesverbal u miratua.

2. Raporti periodik i buxhetit për periudhën Janar-Shtator 2022 i Komunës së Junikut,

Sqarimin dhe raportimin e raportit periodik te buxhetit për periudhën Janar-Shtator 2022 i komunës se Junikut e beri Drejtoresha për Buxhet dhe Financa znj. Vjollca Qestaj e cila fillimisht i përvendoset të gjithë, e më pas e sqaroi Raportin para anëtarëve të Kuvendit.

z.Leonard Llolluni, sa i përket shpenzimeve unë kam tri pika, te shpenzimet e telefonit i keni në total 6427€ që për një Komunë te vogel si Komuna e Junikut janë shpenzime të larta, karburante për automjete keni shpenzuar nga janari 12176€ që për komunën e Junikut është shumë e lartë e shpenzimeve, si dhe keni dreka zyrtare 2332€.

z.Lulzim Gacaferi, kam disa çeshtje por nje sqarim shtesë shërbimet tjera kontraktuese te Sherbimet Publike keni 20616€ të më sqaroni me gjansisht, te shpenzimet telefonike, e kam biseduar edhe para tre muajve ketë temë, dhe kam kërkuar nga ju qe fatmirësisht ka kompani telefonike qe ofertojnë sidomos per institucionale pak ose lira deri ne 22€, kjo shumë e prezantuan e shpenzimeve telefonike është shumë e lartë për komunën e Junikut, dhe unë mendoj se paratë e taksa paguesve tanë duhet te kursehen aty ku është e mundur, çeshtja tjetër është karbuartet për automjete, 1765€ zyra e Kryetarit kjo është ne rregull sepse Kryetari i duhet te udhetoje per ne Prishtinë, por çka mua me brengosë është, te administrata kemi 1561€, kuse të shërbimet publike kemi 5201€, komuna ka 5 km, vije lartë poshtë dhe mendoj se për këto kilometra është një shumë e lartë e shpenzimeve dhe e pa kuptimit, çeshtja tjetër është mirëmbajtja e ndërtesave, për cilat ndërtesa bëhet fjalë apo keni menduar për objektin e komunës, oobjektit e shkollave, objekti i shëndetsisë apo çka keni menduar? Sepse në Komunën tonë nuk ka ndertesa, shuma është 4344€, pastaj keni dreka zyrtare 2332€ duhet te dihet se nga kush ka ardhur, nëse është nga zyra e Kryetarit atëherë është e arsyeshme, shpenzimet energjetike, komuna duhet qe te bejë të mundur te kursehet energjia sepse tanë ne terë botën janë duke u marë masa qe te ketë kursime energjetike, dhe çka me bëri përshtypje negative te raporti finaciar, mobile me pak se 1000€, kompjuter më pak se 1000€, a ban me na sqaruar ketë se për çka bëhet fjalë ne faqe numër 9.

zArten Hamza, përvendoset për të gjithë, desha me u ndërlidhur tek këto kode ekonomike, këto janë kode ekonomike sipas planit që ka qeveria, dhe organizatat buxhetore përmes këtyre kodeve ekonomike i benë shpenzimet e mjeteve, komuna nëse bane shpenzime atëherë duhet tejenë te njejtat me ato kode qe janë të përcaktuara, ndërsa sa i përket shpenzimeve tjera kontraktuese janë te përfshira shpenzime kontratata mbi vepër, obligime nga viti i kaluar janë 70407€, transporti i nxënsësve 11964€, shërbimet e printimit dhe e kopjeve, 2978€ si dhe dezinfektuesi i vendosur ne hyrje te QKMF_së, ne hyrje te objektit te Komunës, si dhe ne hyrje te objekteve te shkollave, 270€ që ka qenë obligim i vitit te kaluar po ashtu hynë mobilimi i klasave ne parashkollore në bashkëfinancim me Caritasin, ne vlerë prej 2250€, mirëmbajtje e ndriçimit publik në vlerë 500€, rregullimi i pusetave 1940€, desifikimi i objekteve shkollore ne vlerë 607€, furnizimi me plisa

me rastin e manifestimit te 110 vjetorit te "Kuvendit i Junikut" 715€ si dhe furnizimim me billborda po ashtu me rastin e 110 vjetorit te "Kuvendi i Junikut" 970€, ne total janë 92696€.

z.nj.Leonora Shehu, sa i perket shpenzimeve te telefonisë nga Administrata gjithsejtë është 1952€, ne e kemi pranuar një faturë nga telefonia Vala e që është nga zyra e Kryetarit dhe ne mungesë te mjeteve nga zyra e Kryetarit pagesa e kësaj fature eshte bere nga Administrata.

z.Lulzim Gacaferi, po me intereson a keni berë kontratë te re me operatoret e telefonisë.

z.nj.Leonora Shehu, jo nuk ka kontratë të re sepse kemi një kontratë që është valide deri ne fund te ketij viti 2023.

Znj.Vjollca Qestaj, u pa se ka shqetsim te madh per shpenzimet ne kategorinë ne mallra dhe shërbime , unë fola ne per një vit fiskal, dhe buxheti ndahet per një vit fiskal dhe ai buxhet duhet te shpenzohet per atë vit fiskal por ajo çka ka ndodhur në ketë vit 2022 është se ne më shumë se 105000€ boregje te vitit 2021 kemi paguar ne vitin 2022 e ato borgje perfshihen borgjet e derivateve, për telefoninë mobile.

z.nj.Gentiana Tofaj, përshendetje për te gjithë, u përmenden disa shpenzime nga zhvillimi ekonomik ne shumë prej 980€ është e vertetë qe nuk është borgj i viti te kaluar, mirepo ne kemi patur një manifestim "Ditët e Gjeravices" dhe me ketë shumë është paguar dreka.

z.Demokrat Ganijaj, pershendetje per te gjithë, kur jam emëruar drejtor me kan ardhur dy fatura per Gusht dhe Shtator te vitit 2021 njera është ne shumë prej 1300€ dhe tjetra është në shumë prej 1500€, janë afër 3000€ borgje per derivate nga viti 2021, por pavarsisht kesaj në kuadër te drejtorisë janë automjeti i Inspektorëve, kamijonat e Zjarrfiksëve, traktori dhe është bageri qe e kemi si donacion nga bashkvendasi donacion per rrafshimin e mbeturinave, dhe per këto arsyese neve si Shërbime publike na bejnë shpenzues me te mdhenjë te derivateve ne Komunën e Junikut.

z.Leonard Llolluni, per drejtorin e sherbimeve Publike kam një pyetje, a është she ky borgj ne shumë prej 294€ per udhetime jashtë vendit, sepse nëse flitet ne total siç po flitet këtu atëherë del se edhe kjo shumë eshtë borgj, andaj mos folni në total, sepse ka me shumë shpenzime te këtij viti se borgje te viti te kaluar.

z.Xhemë Tofaj, përshendetje për të gjithë, unë desha të pyes Drejtoreshën e e Zhvillimit Ekonomik, kjo për manfestimin e "Ditët e Gjeravices" ne shumën prej 980€ pse është quajtur dreka zyrtare?

z.nj.Gentiana Tofaj, ne momentin qe ka nje marrëveshje në mes Komunës dhe organizatorëve shoqates "Rrasa e Zogut" konsiderohet si kod ekonomik qe ne mundemi me berë pagesën, pra është kod ekonomik kategoria dreka zyrtare.

3. Formimi i komisionit për plotësim-ndryshim të rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2023,

Sqarimn e kesaj pike e beri Kryesuesi i Kuvendit z.Shpejtim Gacaferi.

z.Lulzim Gacaferi, unë propozoj qe meqe jemi tri subjekte te përfaqësuara ne Kuvend të ketë secila perfaqësuesin e vet ne ketë komision.

z.Shpejtim Gacaferi, rregullorja e kuvendit e ka caktuar qe kuvendi të përfaqësohet me dy anëtar.

z.Lulzim Gacaferi, unë protestoj dhe kërkoj qe Kuvendi te përfaqësohet me tre anëtarë secili subjekt me nga një anëtar, permdryshe nuk keni votat tonë dhe do ju barakadojmë.

z.Rajmonda Krasniqi, sa i përket ketij komisioni ne grupi i AAK_se tërhiqemi nga përfaqësimi te ketij komisioni.

z.Leonard Llolluni, përkundër kësaj kryesues unë jam qe përfaqësimi i kuvendit ne ketë komision te perfaqsohen nga tri subjektit me nga një anëtar.

z.Lulzim Gacaferi, edhe grupi i LVV_je tërhiqet nga përfaqësimi ne ketë komision.

z.Sadri Krasniqi, grupi i LDK-se propozon z.Sadri Krasniqi, si dhe z.Zenel Maloku nga AAK_ja.

z.Zenel Maloku, unë nuk pranoj sepse subjekti im AAK u deklarua për mos përfaqësim në ketë komision.

z.Shpejtim Gacaferi, kemi një propozim nga kuvendi, e qes ne votim, prezent ne sallë gjinden 13 anëtarë të kuvendit, kush është për? për 5 vota, kundër 2 vota, abstenim 6 vota, konstatoi se propozimi kalon.

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës për hartimin e rregullores për Institucionet edukativosimore të Komunës së Junikut,

Sqarimin dhe aryetimin e beri z.Xhavit Velijaj drejtor i Arsimit, i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë dhe me pas e arsyetoj aprovin e kerkesses per hartimin e rregullores për Institucionet edukativosimore ne Komunën e Junikut.

z.Shpejtim Gacaferi, meqë nuk ka pyetje po sqaroj se përbërrja e këtij komisioni është prej pesë anëtarëve tre nga ekzekutivi dhe dy nga kuvendi, ekzekutivi ka propozuar: z.Xhavit Velijaj Drejtori i DARS kryesues, z.Arton Krasniqi anëtar dhe z.Turim Ganijaj anëtar, presim edhe dy propozime nga kuvendi.

z.Lulzim Gacaferi, pse duhet prap te perseritet kjo, qe kuvendi te ketë vetëm dy anëtarë, unë ju lutem mos e diskriminoni LVV_je sepse do ishte shumë më transparente te qe kuvendi te perfaqsohet me nga një antar nga secili subjekt.

z.Leonard Llolluni, kryesues une propozoj që ne secilin komision kuvendi të përfaqësohet me tre anëtar nga secili subjekt me nga një anëtar sepse do ishte me transparente.

z.Sadri Krasniqi, grupei i LDK_se propozon z.Alfred Gaxherri.

z.Xhavit Velijaj, komisioni mund te perbehet nga tre, pesë apo shtatë antar, por çeshtja eshtë që në perberjet të ketë anëtar qe kane njohuri ne aspektin profesional, grupei fillimisht e punon si draft dhe me pas e kalon edhe dy here nëpër kuvend ky dokument për miratim.

z.Lulzim Gacaferi, ku ka këtu profesionalizëm, unë propozoj qe ekzekutivi ti ketë dy anëtar, kuvendi tre antar dhe ne e votojmë.

z.Besart Tofaj, pershendetje per te gjithë, unë kërkoj që të bëhet një lëshim në ketë pikë që kuvendi ti dërgoj tre anëtar.

z.Zenel Maloku, unë e di se kuvendi është organ me i lartë se ekzekutivi, kuvendi jemi ne dhe ne jemi perfaqësues të qytetarëve, te gjitha votat e Komunës se Junikut i ke këtu, andaj propozimi i tyre eshte i drejtë, që kuvendi ti dërgoj tre anëtar ne ketë komision.

z.Xhavit Velijaj, numrin e përberjes se komisionit e percakton rregullorja e kuvendit dhe ky draft ka me kaluar nëpërmjet KPF_se dhe kuvendit andaj nuk ka këtu kurrfarë tejkalimi te kuvendit.

z.Lulzim Gacaferi, Drejtor i nderum unë po di se kalon nëpër Kuvend por çeshtja është të mos transparencë dhe injorimi i LVV_je ketë nuk e lejoj.

zn.Rajmonda Krasniqi, ne KPF e kemi diskutuar vetëm si çelës, propozimi i anëtarëve është mbetur të bëhet në kuvend.

z.Leonard Llolluni, kryesues qite ne votim si çelës a jemi per dy anëtar apo për tre anëtar?

z.Sadri Krasniqi, une propozoj qe numri i anëtarëve te rriten në shtatë.

z.Zenel Maloku, unë propozoj qe komisioni te jetë në përbërje prej tre anëtarëve nga Kuvendi.

z.Shpejtim Gacaferi, e qes ne votim qe komisioni te jetë në përbërje prej tre anëtarëve të kuvendit kush eshte për? për 13 vota, kundër 0 vota, abstenim 0 vota, tani i pres propozimet nga ana e juve, LDK propozon z.Alfred Gaxherri, AAK propozon znj.Rajmonda Krasniqi, LVV propozon znj.Eliza Pepshi, unë propozoj qe nga ekzekutivi te hiqet propozimi i tretë që është z.turim Ganija dhe komisioni te përbehet nga z.Xhavit Velijaj Kryesues, z.arton Krasniqi anëtar, z.Alfred Gaxherri anëtar, znj.Rajmonda Krasniqi anëtare dhe znj.Eliza Pepshi anëtare,e qes në votim, ne sallë jan prezent gjithjes 13 antar te kuvendit, kush eshtë për ketë përbërje? 13 vota për kundër 0, abstenim 0 vota, konstataoi se komisioni u miratua.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e një antari të KKSB_së,

Sqarimin dhe arsyetimin e beri nënkytetari i Komunës se Junikut z.Besart Tofaj.

z.Zenel Maloku, unë nuk e perkrahi që anëtar i këtij komiteti te jetë me vendbanim jashtë Junikut, do ishte mirë qe anëtarët ne komitete te janë banorë te Komunës se Junikut sepse efekti i punës se atij komitetit do të ishte më i lartë.
z.Lulzim Gacaferi, ne si LVV_je ne e perkrahim propozimin e “Teqes”, dhe do ta votojmë.

z.Sadri Krasniqi, edhe grupi i LDK_se perkrah propozimin e Teqes, sepse ne e dimë se Teqja nuk mbulohet vetem prej Junikut por mbulohet prej gjithë Kosovës dhe është e drejtë e tyre se kënd e delegojnë, keshtu ishte edhe më parë.

z.Shejtim Gacaferi, propozimin e kemi atëherë e qes ne votim, në sallë prezent jane 12 anëtarët e Kuvendit, kush është për? për 12 vota. Kundër 0 vota, abstenim 0 vota konstatoi se zëvendësimi i anëtarit te KKSB_ se u miratua.

6. Shqyrtimi i kërkesës së antarit të kuvendit rrethe mirëmbajtjes dhe kujdesit të deponisë së materialeve interne në Komunen e Junikut,

z.Xhemë Tofaj, ketë debat e kam kërkuar ne emer te grupit te LVV_je, keshtu qe per sqarim dhe arsyetim me te gjer ja kaloj fjalen shefit te grupit te LVV_je.

z.Lulzim Gacaferi i cili me pas e sqaroj dhe e arsyetoje kerkese dhe beri pytje per drejtorin e Sherbimeve Publike, se cila eshte interes i Komune se Junikut qe ju te ja lejoni te hudhen disa dhjeta tona material qe permban materje te demshme kancerioze dhe kemikale, po ashtu me tregoni per shpenzimet e fikjes se zjarrit, dhe si eshte e mundur qe ju te thoni njerzeve kompetent dhe inspektorave qe kur jane hudhur keto mbeturina te kompanis Comedita Home, se ju e merini persiper kete dhe nuk lejoni qe te gjobitet kompanija ne fjale, cila eshte interes i komune dhe çfaret ka fituar komune me kete, per mua si qytetar i kesaj komune por edhe si përfaqësuesi i këtij kuvendi eshte shqetsuese kjo qfarte ka ndodhur.

z.Demokrat Ganijaj, a ban me ta bere një pytje, prej kut po rrjedhe kjo se komuna e ka lejuar.

z.Lulzim Gacaferi, puntoret, zjarrfiksit qe ishin prezent ne ate dite, po ashtu ju ishit aty prezent dhe para syve e juve jane hedhur dhjetra tone syngjer apo si ta quaj shpuze qe bart substanca kemikale, dhe ju keni qene prezent, ne do te marim masa kundër juve, dhe kompanisë ne fjale do me marim masa juridike. Une deshiroj te di nga ju pse keni lejuar një gja te tille te ndodhe, pse jeni invelvuar ju keni qene prezent aty.

z.Xhemë Tofaj, qeshtja eshte te drejtori, sepse nuk ka te drejte te thotë se nga ka rrjedhur informacioni por te per gjigjet ne pytjet qe po i behen, për mendimin tim kjo është ironi dhe ti si kryesues nuk duhesht ta lejosh kete gjest.

z.Lulzim Gacaferi, une besoj fuqishem se te gjitha këto gjera qe kanë ndodhur ne komune tone, se pari i jepni imazhe te keq Kryetarit te Komunës se Junikut, me vjen keq se po e them por ju e demtoni komunen e Junikut demtoni qytetaret tone dhe është për te ardhur keq.

z.Leonard Llolluni, desha ta pyes drejtorin meqë është drejtori i shërbimeve publike dhe ka edhe inspektorianen, a ke inicuar kete ras ne polici ti si drejtor.

z.Demokrat Ganijaj, e para komuna nuk e ka lejuar ketë as ne si drejtori dhe nuk kemi pasur as kerkese per lejimin e kesaj, dhe me e tregu ne detaje ketë ngjarje, ka qen drek dhe kemi pare disa kamijona qe jane duke quar dhe ne deponi, e kam thirrur inspektorin dhe jemi shkuar me qellim per te mos lejuar qe ta qet ne deponi dhe kur jemi shkuar kemi par se është ka qesin dhe dhe materiali syngjer, e kemi urdhëruar qe ti largoje ato materiale dhe ja kemi ndaluar ti hudhe ne deponi, mire por ata na kan then se neve na ka ftuar pronari i tokës, ne i kemi thënë se pronën private mundesh me mushur me dhe por jo me ketë material dhe e kemi detyruar qe ti largoje syngjeart dhe ne prezencen tone i ka larguar, po se kush ja ka vure flaken ne nuk e dimë, dhe meqe zjarrfikësit e ka mare informatën ka shkuar qe ta sïkin zjarrin atëherë kanë pasur pengesa nga pronari i tokes, dhe me kete as demokrati si individ po as komuna nuk kanë pasur te bëjnë asgjë me kete qeshqje, perkundrazi i ka ndalu dhe i ka shti me i largu ato materiale.

z.Lulzim Gacaferi, sa letar ndeshkuese keni bere ju si Komune ndaje kompanisë ne fjale, dhe si eshte e mundur qe ti personalisht t'ju thuani inspektoreve se unë e mare ketë përsipër, ju duhet te keni kujdes me mua sepse une ju padis, i padis edhe ata qe kanë vënë zjarrin, edhe zjarrfikësit edhe policine, ju keni sjelle me dhjetar mijia tona ne komune tone material kanceriogjen, ti ju ke thane inspekcorave, zjarrfiksave se ti e mere persiper kete.

z.Xhemë Tofja, kam një pyetje për nënkyretarin, ne kemi kérkuar një raport nga zjarrfikësit dhe nga policia dhe nuk na ka sjelle kérkesën e kemi bere ne mbledhjen e KPF_se dhe nuk na keni sjelle.

z.Shpejtim Gacaferi, kuvendi nuk ka te drejte te kérkojë raport nga policia, kuvendi nuk ka te drejte te kérkojë raport nga zjarrfikësit sepse ata i raportojne AME_se

z.Leonard Llolluni, drejtor nuk mu pergjigje ne pytje a keni iniciuar rastin ne Polici.

z.Demokrat Ganijaj, per deri sa ato i ka larguar ne nuk kemi inicuar rast ne polici.

z.Xhemë Tofaj, drejtori z.Zenun Shala me ka thënë se ne prezencën tone i ka shkarkuar dy kamijona dhe kan vazhduar te nesmren po me te njëjtin avaz pa ndaluar ketë e ka thënë ne mbledhjen e KPF_se, kjo eshte edhe ne procesverbal dhe mund te jua sjelli.

z.Zenun Shala, përshëndetje te gjithëve, kryetari komune te dielën me te par tymin me ka marr mua dhe kemi shkuar te shikojmë se ku është duke djegur zjarri dhe kur kemi shkuar kanë qenë dy kamijona te zbrasur, deri sa ne ishim duke zbritur nga makina ata kanë ikur, zjarri ka qen shume i madhe dhe menjeher i kemi thirrur zjarrfiksat, dhe kan ardhur, zjarrfikësit e kanë evituar zjarrin na mali qe mos te zgjerohet, dhe per fat te mire ate nate ka ra shi dhe zjarri është shuar, te nesemren ne mengjes kemi shkuar se a eshte shuar zjarri, dhe kur kam shkuar atu kanë ardhur edhe dy kamijona tjer dhe nuk i kam lene te shprazen kjo është kështu dhe kështu kam thënë edhen ne mbledhjen e KPF_se.

z.Zenel Maloku, drejtori z.Ganijaj po bie ndesh me fjalën e vet sepse ne fillim tha se i kanë shti qe ti largojnë ata syngjerë e me pas është ndezur zjarri atëherë kujt ja kanë vu zjarri nëse nuk

keni lejuar ti shkarkojnë syngjerat, kjo nuk është e mundur qe ata te vine ditën e parë te dytën dhe te treten pa dijeninë e dikujt, këtu ka dijeni dhe dore komuna.

z.Dervish Bajraktari, përshëndetje për te gjithë, drejtori z.Ganijaj tha se i kanë larguar kamionët, ndërsa drejtori i nderuar z.Zenun Shala tha se aty ishin dy kamionë, ju i keni larguar dy kamionët po çështja është se për se nuk keni iniciuar rast ne polici për këta dy kamionët qe kanë hudhur syngjart aty dhe i kane djegur, pse ata te mos marrin përgjegjësi apo gjobe për atë qe kane dëmtuar Komune e Junikut.

z.Sadri Krasniqi, une e pashe qe deponija ishte mbyllur, a keni marur masa qe te ketë deponi diku tjetër sepse qytetaret kane nevoje qe ti hedhin mbeturinat inerte.

z.Demokrat Ganijaj, ne kemi një vendim te viti 2018nga kuvendi qe është caktuar vendi “Arat e Gata” qe gjendet ne mes lagjes Qok dhe lagjes “Miroc” është prone publike dhe jemi duke shiquar mundësit dhe nëse atje plotësohen këto kusht do vendosim qe aty te kemi një deponi për mbeturinat inerte.

z.Besart Tofaj, deshta ti përgjigjesh z.Xhemë Tofaj, sa i përket raporteve qe i keni kërkuar unë do i sjelli ne mbledhjen e radhës nëse këto raporte nuk cenojnë ndonjë rast te iniciuar ligjorë.

z.Lulzim Gacaferi, unë ende nuk kam mare përgjigje nga Drejtori se sa i ka kushtuar komunës ky dëmë i shkaktuar nga kjo kompani, ne e dimë saktë se ti je involvuar ne ketë rast, a je ne gjendje qe te japësh dorëheqje sepse Juniku nuk e meriton një Drejtor te tille.

z.Demokrat Ganijaj, ne ende nuk e dimë kur te na vine faturat mund te dimë.

z.Xhemë Tofaj, kryesues ne propozojmë qe te formohet një komision për ketë rastin qe ka ndodhur ne deponin e mbeturinave inerte, një komision pre tre apo pese anëtarëve.

z.Lulzim Gacaferi, LVV_je propozone z.Xhemë Tofaj.

z.Dervish Bajraktari, AAK propozon z.Zenel Maloku.

z.Xhemë Tofaj, propozoj z.Leonard Llolluni.

z.Shpejtim Gacaferi, atehher kemi një propozim për formimin e një komisioni ad-hoc, me propozimet e lartcekura, e qes ne votim kete komision ne salle janë prezent 12 anëtar te Kuvendit, kush eshte per, per 9 vota, kunder 0 vota abstenim 0 vota.

7. Kërkesë për Draft Statutin e QKMF_së “Dr.Ali Hoxha”-Junik,

Sqarimin dhe arsyetimin e beri drejtori i Shendetsis, z.Fatos Shala i cili fillimisht i përshëndeti te gjithë te pranishmit me pas e sqaroj dhe e arsyetoj para anëtarëve te kuvendit draft statusin e QKMF_së “Dr.Ali Hoxha”

z.Sadri Krasniqi, ne si grup i LDK së e përkrahim, mirëpo presim qe për leximin e dyte ta kemi materialin edhe fizik dhe me kohe.

z.Shpejtim Gacaferi, meqë nuk ka kërkesë tjetër e qes ne votim ne sallë prezent janë 13 anëtar te kuvendit, kush është për? për 13 vota, kundër 0 vota, abstenim 0 vota, konstatoi se draft statuti për QKMF_ne leximin i pare u miratua.

8. Diskutimi për shkatërrimin e Varrezave ne fshatin Gjocaj.

z.Leonard Llolluni, kjo çështje është ngritur si shqetësim para një muaj para se te publikohet ne medij, ka qene asamblisti z.Zenel Maloku i cili ka pyetur drejtorin e shërbimeve publike se ato varre a janë ka largohen nga ana e Komunës apo ne mënyrë private, dhe si përgjigje ka mare nga drejtori se ajo çështje s'ka te beje me Komune, me pastaj kam dëgjuar ne media se janë dëmtuar varrezat ne fshatin Gjocaj, dhe unë ju beje pyetje Drejtorisë për Shërbime publike, inspektorëve ku një pronë publike komunale dëmtohet a keni marr masa ndëshkuese për dëmtuesit e pronave komunale ne ketë rast te varrezave.

z.Demokrat Ganijaj, sot po i vendoset kapaku kësaj Çështje sepse krejt kjo është çështje politike, ajo pjesë menaxhohet nga parku nacional dhe inspektimi i asaj pjese nga inspektorat komunal është e ndaluar, nuk ka as uzurpim as kurrgjë tjetër.

z.Leonard Llolluni, unë kam qene edhe vet Drejtor, dhe kur ka ardhur çështja për nderimin e staneve ne bjeshkë dhe shume çështje tjera prokuroria ka kërkuar fillimisht dokumente nga ne si Komune a kemi ndërmarrë veprime, dhe fshati Gjocaj është pjese e Komunës se Junikut, nuk është prone e parkut nacional, parku nacional menaxhon vetëm me pyjet, me ruajtjen e mjedisit.

z.Zenel Maloku, unë ketë çështje e kam thënë edhe me parë, ka qytetar si Sahit Rama qe me ka thënë se e ka thirr drejtori z.Demokrat Ganija e i ka thënë se duhet me i larguar varret sepse duam ta zgjerojmë rrugën, dhe ky qytetar është detyruar qe ti largoje dy varret dhe i ka kushtuar 1400€ me i ç ‘varrosë. Mu si përfaqësues i fshatit Gjocaj me kane thirrur nga Peja tre persona dhe me kane pyetur se a jam ne dijeni se drejtori i ka rrafshuar varret, unë nuk kam qene ne dijeni, te nesërmen kane ardhur dhe njeri nga ta ka inicuar rastin ne Polici dhe ka kërkuar nga Policia te vinë ne vend te ngjarjes dhe mbasi jemi shkuar ne vend te ngjarjes kemi takuar drejtorin, babin e drejtorit. Dhe me se shumti jam i inatosur ne Polici sepse kur shkuam atje than se kjo paska përfunduar dhe sjellja e tyre si te ishte asgjë. Qytetaret janë te zhgënjen me ketë gjest dhe sipas prokurorisë kjo është një vepër penale, ndërsa ne baze te fes hoxha thotë personit qe ja prish varrin është si te prishesh një shtëpi të nje personi te gjallë , por nëse ja thenë eshtrat dhe ja humbe është si me e vra një te gjallë, dhe e tera kjo si te mos ishte asgjë, unë po ta kisha pushtetin e KFOR_it apo NATO_s një varr nuk do ta kisha dëmtuar, por si duket se Drejtori ka dhenë edhe para për ti dëmtuar këto varre për mua kjo është tmerr.

z.Dervish Bajraktari, mua me vjen keq nga drejtori qe po ju ike përgjegjësive kur mundohet ta paraqes si parke nacional varrezat e fshatit “Gjocaj”, atëherë pse interesohesh mbasi qe fshatrat “Gjocaj” dhe “Jasiqi” janë park nacional pse ju bene thirrje qe te mos hedhin mbeturina aty ku këta qytetarë janë ne prona te vete e qe sipas juve nuk është përgjegjësi e komunës se Junikut, andaj Drejtor mos ju ik përgjegjësive.

z.Lulzim Gacaferi, u diskutuar edhe nga koleget këtu, Drejtor ju po thoni se atë pjesë e menaxhon parku nacional, ne rregull, por parku nacional nuk i menaxhon popullatën, popullatën e menaxhon komuna e Junikut, banorët e asaj pjese paguajnë tatim këtu ne komunën tone. Si

është e mundur qe drejtori i shërbimeve publike te rrafshoje ato varreza, drejtor e ceka me herët, kërkova dorëheqje, edhe një here po e kërkoi, jep dorëheqje sepse nuk je për ketë pozitë, dhe lëshoja vendin dikujt tjetër qe te punoje për te mirën e Junikut, jep dorëheqje sepse i ke krijuar imazh te keq komunës tonë, behu burrë ne aspektin moral dhe thuaj kryetarit me vjen keq kam berë dy gabime qe janë te pa falshme dhe prej sotit nuk jam me drejtor.

z.Demokrat Ganijaj, z.Zenel, unë nuk e di se rrolin e kujt jeni duke e luajtur a te policit a te prokurorit a nuk po te kujt? Rasti ka kaluar ne polici gjykatë dhe ne prokurori, Komuna dhe as Kuvendi nuk kanë kompetencë te shpallin fajtorin apo jo fajtorin, dhe unë krejt çka ndjeje për obligim përballë teje dhe këtyre kolegëve këtu është se nuk e kam keqpërdorur pozitën si Drejtor, dhe diskutimi i juve këtu ne kuvend por edhe neper lokale është vetëm dëmtim i procesit qe është iniciuar ne polici, ne momentin qe merret vendim qe unë kam përgjegjësi penale për ketë rast, unë do te japë dorëheqje nga kjo pozitë.

z.Lulzim Gacaferi, ti është dashur atë dite te japësh dorëheqje ditën qe keni rrafshuar këto varre, ne si LVV_je kemi marrëveshje me LDK qe ne pozita drejtuese te sjellim persona te ndershëm, unë te lutem te japësh dorëheqje qe komuna jone mos te merr imazh te keq, nuk e meritojnë qytetaret e Komunës se Junikut te kenë një drejtor te tillë.

9. te ndryshme

znj.Rajmonda Krasniqi, unë e kam një pyetje për drejtorin e arsimit, çështja është për nxënësit parashkollorë qe janë 40 nxënës dhe mësimi është duke u mbajtur me dy turne me nga dy ore për shkak te mungesës se edukatores dhe mua si prind po me brengos se ato dy ore qe ata po i mbajnë ne bazë te plan programit arsimor po e shohë se nuk janë te mjaftueshme dhe pyetja ime është a do te vazhdoni kështu apo keni menduar ndonjë zgjidhje tjetër.

z.Xhavit Velijaj, ne nga e hëna do te shikojmë mundësitë qe edukatorja te ketë një edukatore mbështetëse për arsyje se është problem te punoj vetëm një edukatore me atë grup moshe, nxënësit janë te vegjël dhe kanë nevojat e veta dhe ka raste qe nxënësit mbesin vetëm për ketë arsy ne mendojmë qe te ketë edhe një edukatore shtesë qe nxënësit mos te mbesin vetëm ne asnjë rast dhe plan program, te shkoj sipas planit te planifikuar.

z.Zenel Maloku, çështja është përrugën “Jasiq-Gjocaj” nga laura, ne ketë kuvend na është thënë se rruga do jete e gjerë 5m, dhe unë e kam matur ne tri apo katër vende diku është 4m diku 4.10m diku 4.20m dhe sipas meje kjo pune është e keqe se përse nuk është rruga e gjere 5m siç është premtuar.

z.Lulzim Gacaferi, unë para dy ditëve isha ne QKMF dhe vërejta disa krevate, karrige te dëmtuara desha me ditë nga Drejtori i Shëndetësisë se a ka ndërmarr diçka për ti zëvendësuar, po ashtu desha me dite se banoret e lagjes “Agim Ramadani” kur do te furnizohem me ujë te pajes nga burimi qe furnizohet edhe pjesa tjetër e Komunës tone, dhe çështja tjetër është zërimi i sallës se asamblesë, kur do te ndodhe, projekt i ekziston e ka nënkyetari dhe unë kam mare garanci nga ministri për mjete financiare.

z.Fatos Shala, unë isha ne QKMF dhe pyeta pikërisht për këta dyshek dhe krevate, me kanë thënë se kane dyshek dhe krevate rezervë dhe do ti zëvendësojnë ti gjitha ata dyshek dhe krevate qe janë te dëmtuara.

z.Besart Tofaj, unë e kam garancinë nga ministri qe do ta sigurojmë ujin për lagjen “Agim Ramadani” ministria do te na ndihmojë sidomos për ujin e pijes.

z.Shpejtim Gacaferi, nënkyetari nuk bon plane bën ekzekutivi, e sa i përket zërimit unë nga dita e parë jam i interesuar qe ta kemi, por kjo shkon nëpërmjet tenderimit.

znj.Ermelinda Llolluni, përshëndetje për te gjithë, kam një pyetje për ty kryesues, a kanë te drejtë asamblistët te lëshojnë sallën e kuvendit pa përfunduar pikat e rendi i ditës sepse mua me duket e pa logjikshëm.

z.Shpejtim Gacaferi, e mirë nuk është po as masë ndëshkuese nuk ka.

z.Leonard Llolluni, unë pata një çështje qe ndodhi me herët, do ishte mirë qe ta kemi zërimin dhe munden me u dëgjuar vetëm ne asamblistët dhe jo këta qe po vijën e qe nuk janë pjesë e Kuvendit dhe ne nuk e dimë se çfarë funksionesh kanë dhe po marrin fjalën pa ju dhanë ju, plus ka po dalin këtu te dera po na fyejnë.

z.Zenel Maloku, lagjja “Agim Ramadani” e ka ujin katastrof nuk është uji i pijshëm dhe do ishte mirë qe komuna te le diçka qe është me pak e nevojshëm dhe te bini ujit ne lagjen “Agim Ramadani”.

z.Lulzim Gacaferi, pyetje për drejtorin e shëndetësisë kur do te betë qe QKMF_ja te funksionoj 24h dhe aparati i rëntgenit kur do te jete funksional dhe ne shërbim te qytetarëve te komunës tonë, dhe pyetje për Drejtorin e arsimit a keni siguruar lëndën djegëse për dimër.


z.Fatos Shala, me afate është problem te flitet por ne kemi mare premtimë nga ministria se do te na mbështesin me staf shtesë dhe ne baze te dhënavë qe te funksionojmë 24h na nevojiten edhe katër infermier dhe dy shofer qe te funksionojmë si duhet dhe nëse zgjidhen këto problem ne qe nesër do ja nisim te funksionojmë 24h.

z.Xhavit Velijaj, po e kemi siguruar.

z.Shpejtim Gacaferi, e shpalli te mbyllur mbledhjen e tectorit 2022

Procesmbajtësi:

z. Esat Hoxha



Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi

